



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL, BUJQËSISË DHE MBROJTJA CIVILE**



***TERMAT E REFERENCËS, SPECIFIKIMET TEKNIKE, KAPACITETI TEKNIK DHE  
PËRLLOGARITJA E FONDIT LIMIT  
PËR  
HARTIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT, PËR EKONOMITË PYJORE “Kodër Lac” dhe  
“Maminas”, Bashkia Durrës.***

## **PËRMBAJTJA**

---

|                                                                                                    |           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. TË PËRGJITHSHME.....</b>                                                                     | <b>3</b>  |
| 1.1 Ekonomia Pyjore “Kodër Lac” .....                                                              | 3         |
| 1.2 Ekonomia Pyjore “Maminas” .....                                                                | 4         |
| <b>2. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN P.M.P.K.....</b>                                            | <b>6</b>  |
| 2.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit.....                                   | 6         |
| 2.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave..... | 7         |
| 2.3. Qëllimi i Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave.....                                 | 8         |
| 2.4. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore.....                | 8         |
| 2.5 Përmbajtja e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore.....                                   | 9         |
| 2.6. Përgatitja e hartave.....                                                                     | 12        |
| <b>3. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE....</b>                  | <b>13</b> |
| <b>4. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT .....</b>                          | <b>15</b> |
| <b>5. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT.....</b>                                                   | <b>15</b> |
| <b>6. REFERENCA LIGJORE .....</b>                                                                  | <b>16</b> |
| <b>7. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.....</b>                                                  | <b>16</b> |
| <b>8. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT.....</b>                                   | <b>19</b> |

## 1. TË PËRGJITHËSHME

**Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave** (më poshtë PMPK) është një dokument teknik bazë për mbarështimin e pyjeve dhe kullotave, i hartuar sipas ekonomive pyjore, me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e një sërë të dhënash për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura, të nevojshme për t'u implementuar në këtë ekonomi pyjore, për një afat kohor të përcaktuar (10 vjet).

Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike. Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, të ndërmarrë vitet e fundit, Bashkisë Durrës, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave e konkretisht V.K.M.-në nr.134 datë 03.03.2021 *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”*, i janë transferuar dhe kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në territorin e kësaj bashkie. Nga 7 ekonomi pyjore që përfshihet fondi pyjor e kullor i Bashkisë Durrës këto ekonomi pyjore nuk kanë Plan Mbarështimi (të hartuara në vitet e fundit), 2 ekonomi janë në proces hartimi ndërsa të gjithë të tjerat kanë vetëm Plan Inventarizimi të hartuara në vite të ndryshme kohore nga ish komunat dhe bashkitë para reformës territoriale dhe për pasojë afati kohor i vlefshmërisë së tyre ka skaduar. Duke patur parasysh faktin se gjatë këtyre viteve në këto ekonomi pyjore kanë ndodhur ndryshime të mëdha në cilësi dhe sasi, të cilat kanë ardhur si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme, dëmtimet nga rënia e zjarreve, zënia e sipërfaqeve pyjore me anë të shpyllëzimeve (kthimi i tyre në vreshta, apo pemtari), ndryshimet në sipërfaqe dhe volum etj..., të cilat nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në regjistrat kadastral të fondit pyjor e kullor ndër vite (në zona të veçanta edhe nuk janë raportuar fare) e për pasojë është krijuar një kakofoni në inventarin e këtij fondi dhe aq më tepër në planifikimin e aktiviteteve në shërbim të pyllit dhe komuniteteve lokale.

Së fundmi duhet të theksohet fakti se mbështetur në ligjin 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, i cili sanksionon detyrimin e Njësive të Qeverisjes Vendore (Bashkitë), për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave. Gjithashtu ç'do ndërhyrje në fondin pyjor/kullor duhet të bazohet tek rekomandimet e planeve të mbarështimit, brenda afatit të vlefshmërisë së tij (10 vjet).

Më poshtë po japim një përshkrim të shkurtër të ekonomisë pyjore që ne propozojmë të kryejmë planin e mbarështimit.

### 1.1 Ekonomia Pyjore “Kodër Laç”

Në ekonominë pyjore “Kodër Laç”, Plani i fundit i Mbarështimit (Inventarizimit) është hartuar në vitin 2007 dhe gjatë kësaj kohe ka pësuar ndryshime të mëdha të vazhdueshme. Ajo shtrihet në Njësine Administrative Manëz, e cila ndodhet në Veri-Lindje të Bashkisë Durrës në një distancë mesatare rreth 20 km nga qendra e bashkisë, dhe mbulon administrativisht fshatrat Manëz, Rade, Kamerras, Borçë, Shkallë, Kuçok, Armath. Terreni është kryesisht kodrinor. Në këtë ekonomi pyjore mbizotërojnë trugishtet me llojet pyjore si: lisi, pisha ndërsa cungishtet dominohen kryesisht nga lisi dhe shkurre ndërsa shkurret janë në sipërfaqe të konsiderueshme që kryesisht përbëhen nga shkurre dhe lis.

| Ekonomia Pyjore           | Përdorimi i Teritorit |            | Sipërfaqja në (Ha) |
|---------------------------|-----------------------|------------|--------------------|
| "Kodër Laç"               | Pyll                  | Trungishte | 105.6              |
|                           |                       | Cungishte  | 1161.39            |
|                           |                       | Shkurre    | 67.07              |
|                           |                       | Totali     | 1334.06            |
|                           | Kullota, livadhe      |            |                    |
|                           | Djerr                 |            | 23.39              |
|                           | Inproduktive          |            | 28.02              |
|                           | Tokë me bimësi pyjore |            | 14.57              |
|                           | Ujore                 |            |                    |
| Totali i ekonomisë pyjore |                       |            | 1400.04            |

**Përlllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planit të mbarështimit është realizuar mbështetur në VKM-në Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik”, e cila paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.**

Fondi limit në total për hartimin e planet të mbarështimit për ekonominë pyjore është përlllogaritur në vlerën 3420395 (tre milionë e katërqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lek pa TVSH dhe 4104474 (katër milionë e njëqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lek me TVSH.

| <b>Ekonomitë Pyjore</b>          | <b>Forma e qeverimit</b>          | <b>Sipërfaqja (ha)</b> | <b>Çmimi për njësi lekë/ha</b> | <b>Vlera totale lekë</b> |
|----------------------------------|-----------------------------------|------------------------|--------------------------------|--------------------------|
| <b>"Kodër Laç"</b>               | Trungishte (Klasa I-III e moshës) | 105.6                  |                                |                          |
|                                  | Cungishte                         | 1161.39                |                                |                          |
|                                  | Shkurre                           | 67.07                  |                                |                          |
|                                  | Kullota, livadhe                  | 0                      |                                |                          |
|                                  | Tokë me bimë pyjore+Inprod.+djerr | 65.98                  |                                |                          |
| <b>Totali i ekonomive pyjore</b> |                                   | 1400.04                |                                |                          |
| <b>TVSH 20 %</b>                 |                                   |                        |                                |                          |
| <b>T O T A L I</b>               |                                   |                        |                                |                          |

## **1.2 Ekonomia Pyjore “Maminas”**

Në ekonominë pyjore “Maminas”, Plani i fundit i Mbarështimit (Inventarizimit) është hartuar në vitin 2012, dhe përgjatë gjithë këtyre viteve ka pësuar ndryshime të mëdha të vazhdueshme. Ekonomia pyjore Maminas është ekonomia e cila shtrirjen e pjesshme të saj e ka në njësinë Administrative Manëz.

Në përgjithësi, terreni është kodrinor me prroska të valëzuara.

Kjo ekonomi pyjore përbëhet nga 4 parcela pyjore të cilat janë bërë pjesë e fondit pyjor të Bashkisë Durrës pas rindarjes territoriale.

Në këtë ekonomi pyjore cungishtet dominohen kryesisht nga dushkajat të përzier me shkozë, frashër, mëlleze, dëllinje, gjineshtër ndërsa shkurret janë në sipërfaqe të konsiderueshme që kryesisht përbëhen nga Shkoza, Frashër, Dëllinjë etj..

Në pasqyrën e mëposhtme, jepen të dhënat e ekonomisë pyjore sipas formës së përdorimit të territorit të sipërfaqes që zënë sipas zërave kadastral:

| Ekonomia Pyjore           | Përdorimi i Teritorit |            | Sipërfaqja në (ha) |
|---------------------------|-----------------------|------------|--------------------|
| Maminas                   | Pyll                  | Trungishte |                    |
|                           |                       | Cungishte  | 66.39              |
|                           |                       | Shkurre    |                    |
|                           |                       | Totali     | 66.39              |
|                           | Kullota, livadhe      |            |                    |
|                           | Djerr                 |            |                    |
|                           | Inproduktive          |            |                    |
|                           | Tokë me bimësi pyjore |            |                    |
|                           | Ujore                 |            |                    |
| Totali i ekonomisë pyjore |                       |            | 66.39              |

**Përlllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planit të mbarështimit është realizuar mbështetur në VKM-në Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”, e cila paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.**

Fondi limit në total për hartimin e planit të mbarështimit për ekonominë pyjore është përlllogaritur në vlerën 165975 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lek pa TVSH dhe 199170 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lek me TVSH.

| <b>Ekonomitë Pyjore</b>          | <b>Forma e qeverimit</b>          | <b>Sipërfaqja (ha)</b> | <b>Çmimi për njësi lekë/ha</b> | <b>Vlera totale lekë</b> |
|----------------------------------|-----------------------------------|------------------------|--------------------------------|--------------------------|
| <b>"Maminas"</b>                 | Trungishte (Klasa I-III e moshës) | 0                      |                                |                          |
|                                  | Cungishte                         | 66.39                  |                                |                          |
|                                  | Shkurre                           | 0                      |                                |                          |
|                                  | Kullota, livadhe                  | 0                      |                                |                          |
|                                  | Tokë me bimë pyjore+Inprod.+djerr | 0                      |                                |                          |
| <b>Totali i ekonomive pyjore</b> |                                   | 66.39                  |                                |                          |
| <b>TVSH 20 %</b>                 |                                   |                        |                                |                          |
| <b>T O T A L I</b>               |                                   |                        |                                |                          |

## **2. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PMPK**

Termt e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar dhe mbështetur kryesisht në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave më pas në zyrë.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të hartojnë Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për këto ekonomi pyjore të Bashkisë Durrës, bazuar në Udhëzuesin e lartpërmendur.

### **2.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit**

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave do të jenë:

- Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonomitë pyjore.
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i parcelave e n/parcelaveve, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse.
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:

- Trungishte
- Cungishte
- Shkurre
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës.
- Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta).
- Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve.
- Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë.
- Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës.
- Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit.
- Hartografimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë:
  - Ekonominë pyjore, ndarjen e parcelave e të n/parcelave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes.
  - Përdorimin e territorit të zonës.
  - Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve.
  - Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë.
- Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.
- Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësie.
- Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore.
- Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit.
- Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë.
- Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
- Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të mbarështimit me palët e interesuara.
- Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Durrës, Ministria e Mjedisit, Njësia Administrative, banorët, shoqatat e përdoruesve të pyjeve etj).
- Recensime të draft-planit të përgatitur.
- Ripunim material pas vërejtjeve të bëra.
- Miratimi paraprak nga strukturat teknike të pyjeve në bashki e më pas në Këshillin Bashkiak.
- Miratimi përfundimtar nga Ministria e Mjedisit.

## **2.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Mbarështimit të P.M.P.K**

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Durrës (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me

strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifikë të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, duhet të jenë:

- ☐ Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen aktuale dhe nevojave të komuniteteve lokale e më gjërë.
- ☐ Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.
- ☐ Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunksionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- ☐ Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.
- ☐ Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.
- ☐ Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.
- ☐ Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.
- ☐ Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme dhe abuzive.
- ☐ Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.
- ☐ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të aktoreve lokale në marjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.
- ☐ Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.
- ☐ Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e të dhënave në SISP.

### **2.3. Qëllimi i hartimit të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që është pjesë e territorit të njësisë Administrative Manëz në territorin administrativ të Bashkisë.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndëveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe koordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit të SISP dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

### **2.4. Fazat që ndiqen, për hartimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore**

Sipas Udhëzuesit në fuqi dhe praktikave më të mira të aplikuara deri më sot, procesi i hartimit të P.M.P.K duhet të ndjekë këto faza:

- a) ***Puna përgatitore*** (Mbledhja e gjithë informacionit dhe bazës materiale të nevojshme, trajnimi, prezantimi para aktorëve dhe grupeve të interesit, sensibilizimi i komuniteteve lokale etj; përgatitja e hartës së punës në terren së bashku me rrjetin koordinativ të



sipërfaqeve provë).

- b) **Puna në terren** (matja dhe mbledhja e të gjithë të dhënave të terrenit, hedhja në fletët e terrenit dhe skedat e përgatitura).
- c) **Puna në zyrë** (përpunimi, interpretimi, sistemimi, shkrimi i draftit etj).
- d) Miratimi (Miratimi paraprak dhe përfundimtar).

### **Puna përgatitore**

- Grumbullimi i të gjithë të dhënave ekzistuese, bazës materiale dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PMPK.
- Prezantimi para aktorëve dhe grupeve të interesit i objektivave, puna që do të bëhet dhe marrja sygjërimeve, kërkesave, vërejtjeve etj, nga këta të fundit.
- Përgatitja e hartës bazë të punës dhe ndërtimi i rrjetit koordinativ të sipërfaqeve provë.
- Hedhja e të dhënave të rrjetit koordinativ në memorien e GPS, për orjentimin më pas në terren.
- Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela bazë, verifikimi i shmangieve të mundshme (nga harta bazë e punës).
- Futja në SISP e planit të ri të mbarështimit dhe menaxhimi i procesit të punës (nëse sistemi është funksional).
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesëmarrjes së aktoreve lokal.

### **Puna në terren dhe përshkrimi parcelar**

- Vizitat në terren.
- Mjetet për punën e terrenit.
- Puna në terren (matjet).
- Puna në terren duhet të kryhet duke përdorur mjetet elektronike bashkohore si: GPS, busull, etj dhe tablet për grumbullimin e informacionit në sipërfaqet prove (përdorimi dhe i skedave dhe formularëve të dorës kur sistemi nuk funksionon).
- Planifikimi inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të sipërfaqeve provë.
- Metoda e inventarizimit dhe kampionimi për matjet e kullotave.
- Produktet pyjore jodrusore (bimët aromatiko-mjekësore, frutat pyjore, lulet, farat etj.).
- Futja e të dhënave dhe kontrolli.
- Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP.

### **Puna në zyrë/raportimi**

Proçesi për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të respektojë standartet në mënyrë që të përftohen produkte finale homogjene (raporti, të dhënat, hartat etj) me qëllim përpunimin e të dhënave, transferimin e tyre në SISP dhe një koherencë me IKP. Pjesët e shkruara të raportit, tabelat dhe hartat duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e dhëna në Udhëzuesin për Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019.

### **Raportimi.**

Subjekti, pas lidhjes kontratës me Bashkin Durrës, për hartimin e planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore duhet të pregatisë dhe dorëzojë këto raporte:

- **Raporti fillestar**, i cili përgatitet pas përfundimit të hazit të parë lidhur me prezantimin e tij tek të gjithë palët e interesit, vizitat e para në terren, krijimin e grupeve të punës, përcaktimin e metodologjisë për punën e terrenit përgatitjen e hartave sipas sistemit të ri koordinativ KRGJSH ku projekti me Shape File dhe LAYER e punuara në GIS të ngastrave pyjore dhe ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë në përputhje me kriteret teknike të udhëzuesit dorëzohen pranë strukturës së monitorimit. Ky raport duhet të dorëzohet brenda 90 ditëve nga firmosja e kontratës.
- **Raporti Dytë** (Draft raporti planit mbarështimit) ky raport duhet të hartohet në përputhje me udhëzuesin në fuqi për hartimin e PMPK dhe praktikat më të mira deri më sot. Ky raport në këtë fazë të punës përmbledh të gjithë të dhënat e marra e grumbulluar nga matjet direkte në terren dhe përshkrimin e elementeve teknike të n/ngastrave të kësaj ekonomie pyjore (duhet të paraqitet brenda afateve kohore të shprehura në planin e punës së paraqitur).
- **Raporti përfundimtar** paraqitet pas miratimit të PMPK, bazuar në aktet ligjore në fuqi.

## **2.5 Përmbajtja e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore**

### **1. HYRJE.**

- 1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK).
- 1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë.
- 1.3. Metodologjia e Punës.
- 1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK.

### **2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË.**

- 2.1. Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore.
- 2.2. Pronësia, administrimi, organizimi.
- 2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative.
- 2.4. Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore.
- 2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore.
- 2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike.
- 2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore.
- 2.8. Gjuetia dhe peshkimi.
- 2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike.
- 2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve.

### **3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

- 3.1. Mbarështimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave.
  - 3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual & propozimet).
  - 3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet).
  - 3.1.3. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela.

### **4. KUSHTET STACIONALE.**

- 4.1. Klima.
- 4.2. Topografia dhe morfologjia.
- 4.3. Gjeologjia.
- 4.4. Tokat.
- 4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë.

4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhiet ujore.

4.7. Rrëshqitjet.

## **5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI.**

5.1. Brezat bioklimatike.

5.2. Pyjet dhe kullotat.

5.3. Tipet e pyjeve.

5.4. Tipet e kullotave.

5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit.

5.6 Biodiversiteti.

5.7. Prania e vlerave konservuese të larta (VKL).

5.8. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin.

5.9. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor.

## **6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

6.1. Analiza e të dhënave për Pyjet.

6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve .

6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes.

6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit.

Paraqitja në formë tabelare e të dhënave për secilën formë qeverisje në lidhje me:

- Sipërfaqen totale kundrejt klasave të moshës.
- Volumin për hektar kundrejt klasës së moshës.
- Sipërfaqen e specieve në raport me klasat e moshës.
- Volumi i specieve kundrejt klasave të moshës.
- Sipërfaqen totale për klasat e prodhimit.
- Volumin total për klasaprodhimi.
- Sipërfaqja sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit.
- Volumin sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit.

6.2. Analiza e të dhënave të kullotave.

6.2.1. Gjëndja e kullotave.

6.2.2 Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre.

6.2.3. Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike.

6.2.4. Mbritshmëria.

6.2.5 Grumbullimi i të dhënave për zonat e djegura në kullota (10 vitet e fundit).

## **7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

7.1 Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve.

7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit.

7.1.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë.

7.1.3. Struktura Vertikale.

7.1.4. Cilësia e materialit drusor.

7.1.5. Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomasës.

7.1.6. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit.

7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare.

7.2.1. Drurët e tharë.

- 7.2.2. Dëmtimet e tjera.
- 7.3. Prerjet e paligjshme.
- 7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit.
- 7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve.
- 7.4 Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave.
- 7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave.
- 7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha.
- 7.4.3. Llojet e bagëtive.
- 7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave.
- 7.4.5. Infrastruktura aktuale.
- 7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore.

## **8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

- 8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë.
- 8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave
- 8.3. Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie.
- 8.4. Objektivat kryesore të PMPK.
- 8.5. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM.
- 8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/menaxhimit.
- 8.5.2. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve
- 8.5.3. Objektivat specifik silvikulturale.
- 8.5.4. Objektivat specifik për kullotat.
- 8.5.5. Objektivat specifik mbi biodiversitetin.
- 8.5.6. Objektivat specifik mbi gjëndjen shëndetsore.
- 8.5.7. Objektivat specifik mbi faunën.
- 8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues.
- 8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës.
- 8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni.
- 8.5.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues.

## **9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

- 9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit.
- 9.2. Prerja vjetore silvikulturore.
- 9.3. Planifikimi vjetor i masave.
- 9.3.1. Masat në Pyje.
- 9.3.2. Masat në kullota.
- 9.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike.
- 9.3.3. Analizën e riskut nga zjarret në territorin e ekonomisë pyjore.
- 9.3.4. Identifikimin dhe hartëzimin e zonave me risk të lartë zjarri.
- 9.3.5. Planifikimin e masave infrastrukturore për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve.
- 9.3.6. Mekanizmat e koordinimit institucional për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarreve.
- 9.4. Masat afat-gjata.
- 9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte.

- 9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte.
- 9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre.
- 9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi.
- 9.4.5. Masat në kullota.
- 9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore.
- 9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike.

## **10. VLERËSIMI EKONOMIK.**

- 10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota.
- 10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve.
- 10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve.
- 10.4 Analiza kosto-përfitim.

### **2.6. Përgatitja e hartave.**

Me rëndësinë që kanë hartat tematike në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

- Tematika e hartave në përshtatje me kushtet e reja të territorit’
- Elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat’
- Dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS duke përdorur sistemin e ri zyrtar KRGJSH.

Hartat që do të përgatiten nga kontraktori në kuadër të planit të mbarështimit duhet të jenë të dixhitalizuara, të gjeoreferuara, me të gjitha elementët identifikues (kuota, rrjeti rrugor, rrjeti hidrik, emërtesat e vendeve, kufijtë e zonave të mbrojtura, izoipset kryesore etj) në shkallën 1:10 000 ose 1:25 000 (në varësi të madhësisë së sipërfaqes së ekonomisë pyjore). Hartat duhet të prodhohen nëpërmjet platformes së informacionit SISIP.

Inventarizimi i grumbujve, metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe specifikimet teknike të hartave do të zbatohen korrektësisht kërkesat në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019.

Plani i Mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqëruar do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD). Cilësia e materialeve që do të përdoren për printimin e planit të mbarështimit dhe hartave duhet të jetë e katorisë më të mirë të ofruar në treg. Hartat duhet të vishen me material plastik rezistues ndaj ujit dhe lagshtisë.

Hartat duhet të realizohen në aplikacionin GIS, me izoipsa, dhe ato që do të përgatiten janë:

1. Harta e Ekonomisë Pyjore (parc/nënparsela).
2. Harta e Funksioneve.
3. Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave.
4. Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe sipërfaqeve të degraduara.
5. Harta e ndërhyrjeve.
6. Harta ortofoto (ndarja parc/n/parcels).

### 3. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këto ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor **12 mujor**, që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme për arritjen e këtij qëllimi deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar (*afati i miratimit përfundimtar mvaret nga institucioni i ngarkuar me ligj*).

Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

| NR.  | FAZAT E PLANIT TË MBARËSHTIMIT                                                                   | M U A J T |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|---|
|      |                                                                                                  | I         | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | N |
| 1.   | Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit .                                |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 2.   | Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikimi qëllimeve dhe objektivave të PMPK. |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 3.   | <b>Puna përgatitore</b>                                                                          |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 3.1. | Trajnimi i ekipit.                                                                               |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 3.2. | Grumbullimi i dekurmentave dhe mjeteve të nevojshme                                              |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 3.3. | Drafti i hartës pyjore (ndarja parcelare dhe rrjeti sipërfaqeve provë)                           |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 4.   | <b>Puna e terrenit (të dhënat bazë)</b>                                                          |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 4.1. | Përgatitja e punës së terrenit                                                                   |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 4.2. | Përshkimi parcelar                                                                               |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 4.3. | Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave                                                             |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 4.4. | Rekomandimet për mbarështimin (objektivat dhe masat)                                             |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 5.   | <b>Raportimi i të dhënave dhe planifikimi aktiviteteve</b>                                       |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 5.1. | Përgatitja e Raportit                                                                            |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 5.2. | Përgatitja e Hartës                                                                              |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 5.3. | Planifikimi vjetor ndërhyrjeve/aktiviteteve                                                      |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 5.4. | Vlerësimi ekonomik                                                                               |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.   | <b>PMPK dhe SISP</b>                                                                             |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.1. | Futja, trajnimi, grumbullimi të dhënave dhe hartave etj.                                         |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.2. | Përshkimi parcelar (të dhëna nga SISP dhe sipërfaqet prove etj.)                                 |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.3. | Ngarkimi i raportit, planifikimi vjetor, hartat etj.                                             |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.4. | Procesi i validimit të PMPK në SISP                                                              |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |
| 6.5. | Miratimi i PMPK                                                                                  |           |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |   |

#### **4. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT**

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit të Mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 2-3 specialistë të pyjeve (inxhinier pyjesh me përvojë në këtë fushë) nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Durrës, të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Mbarështimit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

- Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi.
- Përmbushjen e kërkesave dhe kritereve teknike të manualit të mbarështimit të pyjeve në fuqi për punimet e terrenit dhe ato të zyrës.
- Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori (sipas atyre të deklaruar në konkurimin e hapur), sipas nominimeve të deklaruara në dokumentacionin e konkurimit.
- Respektimin e kritereve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit.
- Zbatimin e afateve kohore për realizmin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht.
- Detyrime të tjera të kontraktorit.

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin zyrtar, në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit. Grupi i monitorimit në përfundim të cdo faze harton raportin e monitorimit dhe së bashku me situacionin e punimeve të realizuara nga kontraktori, ja paraqet zyrës së financës për efekt pagese. Grupi i monitorimit bën dhe reçensimin e Draft Planit të Mbarështimit pasi është paraqitur nga kontraktori dhe ja paraqet organeve eprore, për miratim sipas ligjit.

#### **5. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT**

Draft Plani i Mbarështimit të ekonomisë pyjore i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët lokal (Nj.Adm., shoqatat e pyjeve, komuniteti lokal, Bashkia etj) dhe reçensimit, pasi merr në shqyrtim dhe reflekton të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e bëra nga aktorët e sipërpërmendur. Draft plani i Mbarështimit të ekonomisë pyjore me ndryshimet dhe reflektimet e bëra pas reçensimit i kalon për miratim strukturave të përcaktuara sipas akteve ligjore në fuqi (Miratimi paraprak nga strukturat teknike të pyjeve pranë Bashkisë dhe miratimi përfundimtar nga Ministri i Mjedisit).

#### **6. REFERENCA LIGJORE**

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.



Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”;
- Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M.-në nr.134 datë 03.03.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”;
- Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr. 864 prot, datë 30.01.2019;
- Urdhëri Nr.260, datë 29.06.2026 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogartijen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim Projekti “Plani i Mbarështimit të Pyjeve në Bashkinë e Durrësit”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës Nr.73, datë 23.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës, për vitin 2026 si dhe projekt buxhetin afatmesem të Bashkisë Durrës për vitet 2026-2028.

## **7. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Kapaciteti Teknik)**

---

Operatorët e interesuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit të hapur, shërbim konsulente, për kryerjen e studimit për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomive pyjore “Kodër Laç dhe Maminas”, përveç se plotësimit të kriterëve të përgjithëshme sipas dokumentave standart të tenderit duhet të plotësojnë dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Plotësimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit nga operatorët ekonomik është një domosdoshmëri, për të patur në fund një produkt cilësor që plotëson të gjitha standartet bashkohore në kryerjen e këtij studimi.

Kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të jenë:

### **Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**1.-** Meqenëse në këtë procedurë, kemi të bëjmë me hartimin e planit të mbarështimit për dy ekononmi pyjore, në distancë nga njëra tjetra, për pasojë stafi kryesor duhet të jetë i përbërë nga dy grupe pune në terren (3 specialistë) për secilën ekonomi pyjore, në mënyrë që të arrihen të realizohet në kohë marrja e të dhënave në terren dhe përllogaritjet e punimeve të zyrës. Pra për këtë procedurë OE duhet ketë një punësim mujor të stafit kryesor që do të angazhojë në realizimin e këtij shërbimi jo me pak se 7 të punësuar (personel kryesor) në 3 mujorin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (e barazvlefshëme me stafin minimal, që konsulenti kërkon të angazhojë në këtë shërbim) të vërtetuara nga autoritetet kompetente. Stafi kryesor duhet të figurojë në listpagesat e operatorit ekonomik për 3 mujorin e fundit nga data e publikimit të tenderit.

**2- Stafit teknik kryesor i kontraktorit**, bazuar në volumin e punës (dy ekonomi pyjore) kompleksitetin në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësinë dhe pjekurinë profesionale, duhet të ketë në përbërje specialistë të profileve me eksperiencë pune në fushat respektive, minimale 1 vjet, e vërtetuar me librezë pune, të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 mujorin e fundit**, në profesionet si më poshtë:

- 2 (dy) Specialist Pyjesh (Inxhinier), të cilët do të jëtë dhe drejtuesit e grupit për secilën ekonomi pyjore në studim (Stafit teknik) të punës (të pajisur me "Çertifikate profesionale", për shërbime profesionale për projekttime sipas germës (c) pika 1 neni nr. 3, e Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, "Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota") me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të tyre të qëndrueshëm, aspekteve Silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj. Përdor mirë teknologjinë në marrjen e të dhënave të terrenit dhe regjistrimin online të tyre, sipas programeve të miratuara.
- 2 (dy) Specialist pyjesh/kullotash (Inxhinier) (nga një për secilën ekonomi pyjore) – të pajisur me "Çertifikatë profesionale" në fushën e pyjeve dhe kullotave, me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit, përdorimin e teknologjisë në regjistrimin online të të dhënave dhe që njeh mire territorin në studim.
- 2 (dy) Specialist pyjesh /kullotash ), (nga një për secilën ekonomi pyjore) - me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit dhe që njeh mirë territorin në studim (Inxhinier pyjesh).
- 1 (një) Specialist që njeh dhe përdor programet në GIS, ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgatitjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale (Inxhinier topograf/gjeodet), i pajisur me Liçencë në fushën e projekteve (për sistemet GIS) kategoria 8-C, nga autoritetet kompetente ligjore.
- 1 (një) Pedolog
- 1 (një) Biolog
- 1 (një) Zooteknik
- 1 (një) Sociolog

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit teknik/ekspertëve kryesorë që do të angazhojë në kryerjen e këtij studimi, do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me *kontratat individuale të punës* (e vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), *diplomë*, *Librezë pune*, *CV-të*, *çertifikata kualifikimi*, *studime dhe/ose rekomandime*.

Për stafin kryesor të angazhuar, operatori duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë (që kërkon të realizojë).

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit/ ekspertëve kryesorë do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me kontratat individuale të punës (e vlefshme gjatë kohës së hartimit

të planit), kopje të librezave të punës, dhe kopje të diplomave.

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve të stafit mbështetës do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit nëpërmjet CV-së.

**3. Operatori ekonomik duhet të disponoj certifikatat ISO sipas formatit të miratuar në shqip dhe anglisht ku në fushën e certifikimit të jenë parashikuar punimet e Zhvillimit të Planeve të Menaxhimit në Pyje** si më poshtë:

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë “*Certifikata e mësiperme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe të ketë të specifikuara objektin e kontratës së prokuruar*”.

#### 4. Mjete dhe pajisje teknike

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se zotëron mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

| Mjetet                                                    | Sasia  | Gjendja             |
|-----------------------------------------------------------|--------|---------------------|
| Mjet transporti për personelin tip fuoristrade 4 x 4      | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Aparat GPS                                                | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Diameter matës                                            | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Turjel Trysler                                            | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Lazer metër (distance meter)                              | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Pjerrësi matës+lartësi matës (Hypsometer) apo ekuivalent. | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Kompjuter dhe printera për punime zyre                    | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Busulla                                                   | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Metër shirit deri në 20m                                  | 2 copë | Pronësi/ose me qera |
| Peshore për peshimin e barit                              | 2 copë | Pronësi/ose me qera |

**5. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomike duhet të paraqesin Planin e punës, përfaqshjen teknike dhe Metodologjinë (propozimi teknik), për Hartimin e Planit të Mbareshtimit (për Ekonomin/të Pyjore të ofertuar) i cili duhet të jetë në përputhje me termat e referencës dhe Udhëzuesin e integruar në fuqi për Hartimin e Planeve të Menaxhimit, kuadri logjik ku argumentohen objektivat, aktivitetet, aktorët, rezultatet e pritëshme dhe indikatorët për realizimin me sukses të Planit të Mbarështimit. Subjekti mund të paraqesë dhe justifikojë ndonjë modifikim e përmirësim të Termave të Referencës duke përmirësuar performancën e kryerjes së shërbimit (Këto sygjerrime duhet të jenë konçize dhe me hollësi dhe mund të përfshihen në propozim).**

**Plani i Punës.** Në të duhet të propozohen aktivitetet kryesore për kryerjen e shërbimit, përmbajtjen e tyre dhe kohëzgjatjen, shkalla dhe raportet, kohëzgjatjen (duke përfshirë periudhën kohore të miratimit nga autoriteti i ngarkuar me ligj), dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i punës së propozuar duhet të jetë konsistent me përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, të tregojë mirëkuptimin e Termave të Referencës dhe aftësinë e përkthimit të tyre në një plan pune të realizueshëm. Duhet të përfshihen këtu,

*një listë me dokumentat përfundimtar, duke përfshirë këtu edhe raportet, skicimet, dhe tabelat për tu paraqitur si outputet përfundimtare.*

Metodologjia dhe Përqasja Teknike. Subjekti duhet të shpjegojë si i kupton ai objektivat e realizimit të këtij shërbimi, përqasja me shërbimet, metodologjinë për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të pritshme dhe shkallën e detajuar të këtyre outputeve. Duhet të theksojë problemet që do të adresohen dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për ti adresuar ato. Gjithashtu duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adaptojnë dhe të theksojë përputhshmërinë e këtyre metodologjive me përqasjet e propozuara.

## **8. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT**

---

Bashkia e Durrës me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor që ka në pronësi të sajë, ka planifikuar mjetet financiare për kryerjen e studimit për hartimin e Planit të Mbarështrimit për ekonominë pyjore “Kodër Laç dhe Maminas”.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit që do të hartojë planin e mbarështrimit të ekonomisë/ve pyjore sipërpërmendur.

Përllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit për këtë ekonomi pyjore është realizuar: duke u referuar në VKM-në nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullësor publik”, Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, datë 30.01.2019.- Të dhënat e kadastrës pyjore lidhur me përdorimin e territorit me volumet e fondit të pyjeve/kullotave, për ekonominë pyjore objekt i këtij prokurimi.

- Fondi limit, për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonominë pyjore “Kodër Laç”, bazuar në të dhënat e kësaj ekonomie pyjore, sipas preventivit bashkangjitur është:
- ***Vlera pa TVSH = 3420395 (tre milionë e katërqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë.***
- Fondi limit, për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonominë pyjore “Maminas”, bazuar në të dhënat e kësaj ekonomie pyjore, sipas preventivit bashkangjitur është:  
***Vlera pa TVSH = 165975 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë.***
- Fondi limit, për hartimin e planit të mbarështimit, për ekonomi të pyjore “Kodër Laç dhe Maminas”, bazuar në të dhënat e këtyre ekonomive pyjore, sipas preventivave bashkangjitur është:
- ***Vlera pa TVSH = 3586370 (tre milionë e pesë qindë e tetdhjetë e gjashtë e treqindë e shtatëdhjetë) Lekë.***